Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Blerina Huruglica	**29.12.2023**	**05.01.2024**	**2023/1048**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 25.12.2023, **OE "" AS Tech " SH.P.K."- Prishtinë**, ka parashtruar ankesë me nr: **2023/1048**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë **OE "Infinit " SH.P.**K. lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizimi dhe montimi me Klima (kondicioner)"** me nr. të prokurimit: **"652-23-12732-1-3-6",** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues **(AK) – KUVENDI I KOMUNES - KAÇANIK.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë e kuotimit të çmimit, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: **8,000.00 €.**

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 6

Neni 7

Neni 59

Neni 60

Ankesen e parashtrojme per aktivitetin me nr. 652-23-12732-1-3-6 kunder Vendimit te AK-se te dates 30.11.2023, ku AK ka shperblyer me kontrate OE INFINIT. Ffillimisht kemi kerkuar

qasje ne oferte te rekomanduar por AK nuk na ka ofruar qasje, pastaj kemi bere kerkesen per rishqyrtim me daten 05.12.2023 me te vetmin pretendim se AK nuk na ka ofruar qasje.

AK nuk merr Vendim te kerkeses per rishqyrtim por vetem na ofron qasje ne oferte te rekomanduar permes emaillit. Nga qasja qe paten shohim qe AK ka shperblyer nje oferte te papergjegjshme, OE i rekoamndur nuk i ka plotesuar te gjitha kerkesat e dosjes se tenderit.

Tek kerkesa per kushte te garantimit te dhena 2 vite nga AK, OE nuk ka sjell deshmi se ofron garancion 2 vite. Askund ne oferten e tij nuk ka deklarate te garancionit qe OE te garanton per furnizimet e tij, ky eshte nje kushte i dosjes se tenderit dhe mos plotesimi i tij e bene nje oferet te papergjegjshme automatikishte. Ne vendimin e kerkeses per rishqyrtim AK kete pretendim e hedh posht sepas tyre garancioni ska qene i cekur ne dosje dhe nuk mund te eleminohet oferta per diqka qe nuk eshte cekur, kjo nuk qendron sepse ne faqen 6 te dojes **II.7 Kërkesat e garantimit: 2 vjeqare. shkruan shume mire kerkesa per garancion nga AK.**

Kete e themi nga te gjitha praktikat e deritanishme sa i perket Garancionit te kekruar, ku ne cdo rast te gjykuar nje oferte eshte eleminuar nese nuk ka ofruar garancion. OE ne oferte poashtu nuk ka referenca te dorezuara, nga vleresimi qe i kemi bere dokumenteve qe kemi pasur nga qasja.

Perfundimisht konsiderojme se AK ka shperblyer nje oferte te papergjegjshm, prandaj kerkojme APROVIM te Ankeses tone kthim te lendes ne rivleresim, shperblim te ofertes tone me kontrate si oferten me te lire te pergjegjshme.

KRITERET PËR VLERËSIM

II.6 Afatet kohore për nisje dhe/apo përfundim të kontratës: në muaj ose në ditë **10** ose

fillim përfundim

II.7 Kërkesat e garantimit: 2 vjeqare.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

KAÇANIKU

Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES[1]

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli i kontratës: “Furnizimi dhe montimi me Klima(kondicioner).”

Nr. i Prokurimit:	KA652	2	3	1	2	7	3	2	1-3	6

Nr.	Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave[2]
1.	“LEDS” SHPK Prishtinë	8,790.00€
2.	“As Tech” shpk Prishtinë	5,980.00€
3.	“Geo Group Ing shpk Prizren	6,977.00€
4.	NTSH “Ar Driti” Ferizaj	7,680.00€
5.	“Infinit” shpk Prishtinë	5,388.00€

Rezultati i aktivitetit te prokurimit: *Komuna Kaçanik* **shpërblen** me kontratë ““Infinit” shpk Prishtinë me çmim prej 5,388.00€
Data: 29.11.2023.

Letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm [1]

KUVENDI I KOMUNES - KAÇANIK, RR "AGIM BAJRAMI" P.N. -71000 KAÇANIK

“As Tech” shpk Prishtinë

Nr. i prokurimit:	**652-23-12732-1-3-6**
Nr i brendshëm	

Titulli: Furnizimi dhe montimi me Klima (kondicioner)

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

N/A

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **" AS Tech " SH.P.K.**

Aktiviteti i prokurimit: **"Furnizimi dhe montimi me Klima (kondicioner)"** me nr. të prokurimit: **"652-23-12732-1-3-6",** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues **(AK) – KUVENDI I KOMUNES – KAÇANIK, ka filluar me publikimin e njoftimit për kontratë me datë 15.11.2023, hapja e ofertave është bërë me datë 21.11.2023, njoftimi B58 data 30.11.2023. OE ankuesi është shpallur si i pa suksesshëm, ndërsa OE i rekomanduar është shpallur OE Infinit Shpk.**

Tutje, OE ankuesi pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim, me datë 28.12.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP.

I njëjti, pretendon se AK nuk ka vlerësuar drejtë ofertat dhe se ka shkelur nenet 6,7,59,60 të LPP_së.

Pretendimi i OE ankues kundër OE të rekomanduarit:

OE i rekomanduar nuk ka ofruar garancion 2 vjeçar, prandaj nuk ka plotësuar kushtet e dosjes së tenderit, andaj duhet të shpallet i pa përgjegjshëm.

Ekspertja shqyrtuese pas analizimit, vlerësimit të shkresave të lëndës sqaron se, **AK në vendimin** mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, ka deklaruar se garancioni nuk ka qenë kusht në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit.

Përderisa pas verifikimit të dosjes së tenderit shohim se AK në DT tek neni II ka kërkuar garancion:

NENI II QËLLIMI I KONTRATËS

II.1 Titulli i kontratës: **Furnizimi dhe montimi me Klima (kondicioner)**

II.2 Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP): 31000000-6

II.3 Qëllimi i kësaj kontrate është *[dërgesa], [instalimi], [mirëmbajtja], dhe [shërbimi pas-shitjes]* nga operatori ekonomik *punët* ☐ *furnizimet* ☒ *shërbimet* ☐ si në vijim:

Furnizimi dhe montimi me Klima (kondicioner) për nevojat e administratës Komunale dhe QKMF-në

II.4 Specifikimet e detyrueshme teknike - *punët* ☐ *furnizimet* ☒ *shërbimet* ☐ duhet të jenë plotësisht në pajtueshmëri me specifikimet teknike të parashtruara në dosje të tenderit, Aneksi 1.

II.5 Vendi për *"[dërgimin e furnizimeve]"* *"[kryerjen e shërbimeve]"* *"[ekzekutimin e punëve]"* është **Komuna dhe QKMF- Kaçanik**

II.6 Afatet kohore për nisje dhe/apo përfundim të kontratës: në muaj ____ ose në ditë **10** ose

fillim ____ përfundim ____

II.7 Kërkesat e garantimit: 2 vjeqare.

Gjithashtu vlenë të theksohet se, asnjë produkt kohët e fundit nuk blehet pa garancion, kurse në ofertën e OE të rekomanduar nuk gjendet garancioni, andaj si e tillë pretendimi i OE ankues gjendet i

bazuar.

Si përfundim, AK aktivitetin e prokurimit nuk ka vlerësuar konfom nenit 59 të LPP-së, andaj rekomandoj që lënda të kthehet në rivlerësim.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI I KOMUNES - KAÇANIK**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **" AS Tech " SH.P.K.**

Blerina Huruglica